



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.209/3 prot.

Tiranë, më 08.04.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 31, datë 08.04.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË
TROPOJË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË
RREGULLUAR PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil, për nëpunësin Kujtim Sylaj, në institucionin e Bashkisë Tropojë,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës nr. 209 prot., datë 30.01.2026, pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nështë dërguar një informacion nga nëpunësi Kujtim Sylaj, në të cilin parashtrohet se, me urdhrin nr. 366, (nr. 6275 prot.), datë 23.12.2025, të Kryetarit të Bashkisë, ai është transferuar në pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invaliditetit”, në Njësinë Administrative Bujan, pranë Bashkisë Tropojë, në tejkalim të afatit 6-mujor të transferimit, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Në përmbajtje të informacionit, nëpunësi në fjalë, pretendon se është transferuar në këtë pozicion pune, në kundërshtim me rregullat që parashikohen gjatë aplikimit të institutit të transferimit në shërbimin civil, pasi në rastin konkret nuk është respektuar afati i transferimit prej 6 (gjashtë) muajsh brenda një periudhe 2 (dy) vjeçare.

Po kështu, pretendohet se, gjatë kësaj periudhe nëpunësi është paguar me klasë page IV-4 dhe jo sipas pozicionit të kategorisë ekzekutive, të barazvlefshëm me pozicionin ku ka pasur emërimin, në aparatën e Bashkisë, me klasë page IV-3.

Në këto kushte, nëpunësi i është drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga subjektet e ngarkuara me detyra specifike sipas ligjit, në lidhje me zbatimin e institutit të transferimit.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me përmbajtjen e informacionit, vlerësoi se në këtë rast, lindin dyshime të arsyeshme në lidhje me parregullsi në drejtim të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me shkresën nr. 209/1 prot., datë 09.02.2026, “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar me shkresën nr.209 prot., datë 30.01.2026, të dërguar nga nëpunësi Kujtim Sylaj”, ka vënë në dijeni institucionin e bashkisë, për fillimin e verifikimit të kësaj procedure transferimi, duke i kërkuar edhe dokumentacionin përkatës.

Nëpërmjet shkresës nr. 909/1 prot., datë 24.02.2026, me objekt: “Kthim Përgjigje”, protokolluar pranë Komisionerit me nr.409 prot., datë 04.03.2026, institucioni i Bashkisë Tropojë ka dërguar dokumentacionin e plotë në të cilin materializohet procedura e transferimit e ndjekur në këtë rast.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, nëpunësit Kujtim Sylaj, me aktin nr. 4494 prot., datë 15.11.2018, të nxjerrë njëkohësisht nga njësia përgjegjëse dhe Kryetari i Bashkisë Tropojë, i është deklaruar statusi si “nëpunës civil”, në pozicionin e punës “Specialist për Mbajtjen e Hartimin e Dokumentave”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Turizmit, pranë Bashkisë Tropojë.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit, rezulton se me urdhrin nr. 201, (nr. 3241 prot.), datë 18.07.2025, “Transferim i përkohshëm në punë i z. Kujtim Syl Sylaj”, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësi në fjalë është transferuar përkohësisht për nevoja të institucionit në pozicionin “Specialist i Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invadilitetit”, në Njësinë Administrative Bytyç, për një periudhë 6- mujore, pa ndërprerje, duke filluar nga data 25.07.2025.

Më tej, konstatohet se me urdhrin nr. 366, (nr 6275 prot.), datë 23.12.2025, “*Transferim i përkohshëm në punë i z. Kujtim Syl Sylaj*”, të Kryetarit të Bashkisë, sërisht ky punonjës është transferuar përkohësisht për nevoja të institucionit në pozicionin e punës “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invadilitetit*”, në Njësinë Administrative Bujan, të Bashkisë Tropojë, për një periudhë 6- mujore, pa ndërprerje, duke filluar nga data 01.01.2026.

Rezulton se, në aktin administrativ objekt vlerësimi, është përcaktuar se afati kohor për periudhën e transferimit do të jetë 6- muaj pa ndërprerje, ndërkohë që, nëpunësi Kujtim Sylaj, përpara daljes së këtij akti ka qënë i transferuar pa ndërprerje, për një periudhë 6- mujore, në pozicionin “*Specialist i Ndhmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invadilitetit*”, në Njësinë Administrative Bytyç, Bashkia Tropojë.

Në vijim të kësaj analize, vlerësojmë se ligji për nëpunësin civil, parashikon në mënyrë shteruese të gjitha rregullat dhe procedurat në lidhje me proceset e rekrutimit/konkurrimit, transferimit, pezullimit, disiplinës dhe vlerësimit të nëpunësve civilë e si rrjedhim, çdo akt administrativ, i nxjerrë në përfundim të këtyre procedurave, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e tij, si edhe me rregullat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë çdo institut të tij.

Konkretisht, në kreun VIII, neni 48, i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësit civil*”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;*
- b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve;*
- c) për arsye të përkohshme shëndetësore;*

Më tej, në VKM-në nr. 125, datë 17.02.2016, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, pika 2, e kreut I, përcaktohet se:

“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, sipas rastit, përkatësisht brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale, në një institucion të varësisë së institucionit ku është emëruar, në një institucion tjetër të shërbimit civil:

- a) Në interes të institucionit, deri në 6 (gjashtë) muaj me/ose pa ndërprerje, gjatë 2 viteve;*
- b) Për përmirësimin e rezultateve të tij, deri në 3 (tre) muaj pa ndërprerje gjatë 2 viteve;*

c) Për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, të përcaktuara nga komisioni kompetent në bazë të ligjeve në fuqi, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.”.

Ndërsa, sa i takon procedurës që duhet të ndiqet në këtë rast, në pikën 5, të këtij kreu, parashikohet se:

- “... transferimi i përkohshëm, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimin nga ana e nëpunësit të kriterëve të punës ku ai kërkohet të transferohet, si dhe plotësimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil...”.

Në përfundim të afatit të transferimit, referuar pikës 12, kreu I, i VKM-së nr. 125, datë 17.02.2016, nëpunësi kthehet në vendin e punës, me vendim të njësisë përgjegjëse duke respektuar afatet e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi.

Sa i takon pagës për pozicionin e punës, gjatë periudhës së transferimit, në pikën 5, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sanksionohet se:

“Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësi civil përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Në çdo rast, nëse është e zbatueshme, nëpunësi civil përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit në të cilin është transferuar.”

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, vlerësojmë se urdhri nr.366, (nr. 6275 prot.), datë 23.12.2025, i nxjerrë nga titullari i Bashkisë Tropojë, për të transferimin e përkohshëm në detyrë të nëpunësit Kujtim Sylaj, është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material që rregullon institutin e transferimit të një nëpunësi civil dhe akteve nënligjore përkatëse.

Kryetari i Bashkisë Tropojë, nëpërmjet aktit në fjalë, ka urdhëruar lëvizjen në detyrë të nëpunësit duke aplikuar procedurën e transferimit të përkohshëm në kundërshtim me ligjin material, në kapërcim të kufirit kohor të përcaktuar në germën a), pika 1, e nenit 48, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar dhe VKM-në nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, germa a), pika 2, kreu I.

Në këto kushte, urdhëri objekt shqyrtimi, referuar nenit 109, germa d) dhe të nenit 114, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, duhet të konstatohet si i paligjshëm nga ana e organit që e ka nxjerrë atë, si dhe të rregullohen pasojat e ardhura duke urdhëruar rikthimin e nëpunësit Kujtim Sylaj, në pozicionin e punës ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil: “Specialist për Mbajtjen e Hartimin e Dokumentave”, ose në një pozicion

të barasvlefshëm me të, brenda aparatit të Bashkisë Tropojë, në rast se pozicioni është suprimuar.

Gjithashtu, Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me organet e ngarkuara nga ligji me menaxhimin e financave në Bashkinë Tropojë, duhet të marrin masa për verifikimin e pagesave të kryera për nëpunësin Kujtim Sylaj, gjatë periudhës së transferimit dhe kompensimin financiar të tij, me diferencën e pagës më të lartë, ndërmjet pagës së pozicionit ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil dhe pozicionit në të cilin është transferuar.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencave të Komisionerit, të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të nenit 109 dhe 114, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Bashkisë Tropojë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Kryetari i Bashkisë Tropojë, të shfuqizojë aktin administrativ nr.366, (nr.6275 prot.), datë 23.12.2025, “Transferim i përkohshëm në punë i z. Kujtim Syl Sylaj”, dhe të rregullojë pasojat, duke e rikthyer nëpunësin Kujtim Sylaj, në pozicionin e mëparshëm të punës “Specialist për Mbajtjen e Hartimin e Dokumentave”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Turizmit, ose në rast suprimimi të këtij pozicioni pune, në një pozicion të barasvlefshëm me të, pranë aparatit të Bashkisë Tropojë, si edhe të kompensojë financiarisht nëpunësin, nëse ka diferenca në pagesë për pozicionet e punës, ashtu si është analizuar në pjesën arsyetuese të vendimit.
2. Njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Bashkisë Tropojë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15 ditë**, nga marrja dijani për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Tropojë dhe nëpunësi Kujtim Sylaj.

6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)